

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 248/ 2023, 25-09-2023****Parashikimi** nga 25-09-2023, ora 12:00 deri më 26-09-2023, ora 23:59.**PARASHIKIMI METEO****RESHJET**

Sot pasdite (e hënë, dt.25) dhe nesër (e martë, dt.26) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarkun e Korçës, mesatare në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë dhe Elbasan, ndërsa të dobëta në të gjitha qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në disa nga qarqet reshjet pritet të shoqërohen edhe me shtrëngata. Nuk përjashtohet mundësia edhe për raste breshëri, në zona të kufizuara, kryesisht në pjesën jugore dhe lindore të territorit.

TEMPERATURAT

Nesër (e martë, dt.26) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 20 / 30 °C

në vendet e ulëta: 18 / 31 °C

në vendet malore: 13 / 22 °C

ERA

Sot pasdite (e hënë, dt.25) dhe nesër (e martë, dt.26) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë, sidomos në bregdet dhe në terrenet e larta malore.

ZJARRET NË PYJE

Sot pasdite (e hënë, dt.25) pritet niveli "S'KA RREZIK" në të gjitha qarqet. Nesër (e martë, dt.26) pritet niveli i rrezikut "I ULËT" në qarqet Fier dhe Berat dhe "S'KA RREZIK" në të gjitha qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: *Liljana Lata*Koordinator: *Elona Abazi* (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)








Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 248/ 2023, 25-09-2023

Parashikimi nga 25-09-2023, ora 12:00 deri më 26-09-2023, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare					
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare					
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare					
DURRËS	S'KA RREZIK	të dobëta					
TIRANË	S'KA RREZIK	të dobëta					
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare					
FIER	I ULËT	të dobëta					
BERAT	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
VLORË	S'KA RREZIK	të dobëta					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	të dobëta					





LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe


Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke



RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 25 – 26.